



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1710/2 prot.

Tiranë, më 05. 12. 2019

V E N D I M

Nr. 178, Datë 05. 12. 2019

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 151, datë 21.11.2019, e shtetasit A. K., kundër Shoqërisë Digitalb sh.a., në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të gjendjes shoqërore dhe çdo shkak tjetër*¹.

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi shpjegon se, si rezultat i njohjeve të tij personale me ish Administratorin e Shoqërisë Digitalb sh.a., z. A. T., i cili ishte njëkohësisht edhe një prej aksionerëve të shoqërisë, ka filluar punë pranë Departamentit të Antipiraterisë së kësaj shoqërie. Fillimisht, ankuesi ka nënshkruar një kontratë pune 3-mujore në periudhë prove dhe më datë 12.08.2019, ka nënshkruar kontratën e punës me afat deri më datë 31.12.2019.

Gjatë periudhës që ankuesi ka lidhur kontratën e dytë me shoqërinë, shtetasi A. T. ka dhënë dorëheqjen nga pozicioni i administratorit. Me largimin e tij nga kjo detyrë, në pozicionin e Administratorit të Digitalb sh.a. është emëruar R. L. Sipas ankuesit që në momentet e para të emërimit të R. L. në detyrë, Departamenti i Antipiraterisë është nëpërkëmbur, përbuzur dhe nënvlerësuar prej tij. Të gjitha këto janë lidhur me mosplotësimin e kushteve minimale të bazës materiale dhe logjistike nga ana e administratorit të ri. Pavarësisht se kërkesat për plotësimin me bazë materiale dhe logjistike i ishin kërkuar R. L., nga ana e tij nuk u plotësuan.

¹ Pa përcaktuar një cilësi apo një shkak.

Më datë 22.10.2019 ankuesi dhe kolegët e tij të Departamentit të Antipiraterisë, kishin dalë nga ambjentet e punës dhe në kthim janë takuar me administratorin e shoqërisë. Në momentin që janë takuar me të, administratori i ka kërkuar informacion lidhur me shefin e Departamentit të Antipiraterisë. Në përgjigje të tij, ankuesi i ka sqaruar se nuk mban përgjegjësi lidhur me vendndodhjen e tij dhe nuk ka informacion.

Në mesin e muajit Tetor 2019, R. L. ka thirrur ankuesin dhe një kolegun e tij në zyrë dhe i ka kërkuar informacion lidhur me punën që kanë bërë gjatë kësaj kohe. Në përgjigje të tij, ankuesi i ka thënë se fakti që ai si drejtues ka krijuar një Departament tjetër të ngjashëm me atë të Antipiraterisë dhe mosplotësimi i kërkesave të punës kanë lënë pa punë atë dhe të gjithë Departamentin e Antipiraterisë. Në këtë moment, nga ana e R. L. i është thënë se është pushuar nga puna dhe nuk mund të jetë më pjesë e Shoqërisë Digitalb sh.a. Në këto kushte, ankuesi ka kundërshtuar duke i sqaruar se kërkon me shkrim aktin e largimit nga puna dhe arsyet e tij. Në vijim, sipas ankuesit, administratori i është drejtuar duke i thënë të dalë nga zyra.

Më datë 23.10.2019, ankuesi është thirrur nga ana e drejtueses së Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe i është vënë në dispozicion njoftimi i ndërprerjes së menjëhershme të marrëdhënieve të punës, me arsyetimin e fyerjes dhe kërcënimit të administratorit të shoqërisë, si dhe shkelje në mënyrë të vazhdueshme të orarit të punës.

Sipas ankuesit, që në momentin e emërimit të R. L. në pozicionin e administratorit të shoqërisë, në pozicionet drejtuese janë emëruar të gjithë persona të njohur të tij të cilët kanë punuar më parë me të.

Përsa më lart, ankuesi ka pretenduar se largimi i tij nga detyra është bërë për shkak të gjendjes shoqërore dhe çdo shkak tjetër.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Shoqërisë Digitalb sh.a.

Pas shqyrtimit paraprak të saj, u konstatua se ankesa e depozituar pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna prej subjektit ankues, në lidhje me shkaqet e pretenduara dhe lidhjes shkakësore me trajtimin më pak të favorshëm.

- Për këtë arsye, më datë 21.11.2019, me anë të e-mailit, i është kërkuar ankuesit të vërë në dispozicion shpjegime dhe prova, lidhur me shkaqet e pretenduara prej tij, në mënyrë që ankesa të rregjistrohej dhe ti nënshtrohej procedurës së mëtejshme të shqyrtimit.

Sipas informacionit² të dhënë me anë të e-mailit datë 21.11.2019, ankuesis ndër të tjera sqaroi se: *“...nuk kam asnjë dokument ose provë tjetër përveç atyre që kam dërguar në ankesën time...”*.

Në përfundim të arsyetimit dhe informacionit të sipërcituar A. K., nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë fakt apo provë lidhur me shkaqet e pretenduara të diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument, indicie apo provë, për të vërtetuar shkaqet e diskriminimit, apo trajtimin në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese në raport me persona të tjerë.

Neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Në

² I administruar në dosje.

rastin konkret, ankuesi duhet të identifikojë një cilësi apo karakteristikë personale për të cilën pretendon se është trajtuar në mënyrë të pafavorshme.

Nga ana e ankuesit është paraqitur informacion mbi problematikën që ka lidhur me transferimin dhe largimin e tij nga detyra në shkellje të legjislacionit, por nuk ka paraqitur fakte dhe prova apo shpjegime për të provuar shkaqet e pretenduara të diskriminimit dhe për të provuar se trajtimi i pabarabartë i tij është bërë për shkak të cilësive të veçanta që ai ka.

Për sa më sipër, Komisioneri vëren se, A. K. mund të jetë vënë përpara veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme nga ana e Administratorit të Shoqërisë Digitalb sh.a., por në bazë të rrethanave të shpjeguara prej tij, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes me pretendim diskriminimi.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit A. K., për shkak se është haptazi e pabazuar dhe nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja shoqërore dhe çdo shkak tjetër)

(Fusha: Punësim)